



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
KRYETARI

Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1,

www.klsh.org.al. E-mail: klsh@klsh.org.al

Nr. 1011/11 Prot.

Tiranë, më 30/11/2018

V E N D I M

Nr. 177, Datë 30 / 11 / 2018

PËR

**AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË BORDIN E UJITJES DHE KULLIMIT FIER
ME OBJEKT: "AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE", PËR PERIUDHËN 01.01.2017 DERI MË
DATËN 31.08.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Bordin e Ujitjes dhe Kullimit Fier, me objekt "Auditim Përputhshmërie", për periudhën 01.01.2017 deri më 31.08.2018, nuk u konstatuan devijime nga rregullat e prokurimit publike, të rëndësisë materiale për të cilën japim opinion të pakualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Bordin e Ujitjes dhe Kullimit Fier, me objekt "Auditim Përputhshmërie", sipas programit të auditimit nr.1011/1 datë 07.09.2018, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.08.2018.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

I. OPINIONI I AUDITIMIT:

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bordit të Ujitjes dhe Kullimit Fier është mbështetur në: ligjin nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të auditimit "ISSAI 400"; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti Bordit të Ujitjes dhe Kullimit Fier të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), nuk u evidentuan devijime nga kuadri rregullator (kriteret), që zbaton Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Fier.

Përgjegjësit e audituesit janë:

Grupi i auditimit ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) dhe konkretisht ISSAI 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë", pjesë e raportit tonë (faqja 4). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura me siguri të arsyeshme, por nuk garantojmë që auditimi i kryer në përputhje me këto standarde mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mundë të ekzistojë. Gjithashtu, besojmë se, dëshmitë dhe evidencat e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat e arsyeshme për arritjen në opinionin e auditimit.

Opinionit auditimit:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Bordit të Ujitjes dhe Kullimit Fier, nuk u konstatuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilën *japim opinion të pakualifikuar*¹.

II. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje: Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Fier (BUKF), për vitin 2017 ka realizuar 22 procedura prokurimi me fond limit në vlerë prej 134,764,800 lekë, me TVSH dhe ka lidhur 22 kontrata me vlerë prej 125,394,000 lekë, me TVSH dhe për vitin 2018 ka realizuar 27 procedura prokurimi me fond limit në vlerën prej 2786,640,000 lekë, me TVSH dhe ka lidhur po 27 kontrata të me vlerë prej 232,508,000 lekë, me TVSH. Nga auditimi këtyre procedurave në përgjithësi nuk u konstatuan shkelje të qenësishme në lidhje me keqpërdorimet e fondeve publike, por në disa procedura të veçanta u konstatuan edhe devijime nga kuadri rregullator i prokurimeve publike, si më poshtë:

1.1. Gjetje: Në mbështetje të nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe të nenit 36, të VKM, nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit

¹ Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V: Audituesi duhet të shprehë një *opinion të pakualifikuar* mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

publik”, BUKF, gjatw vitit 2017 ka realizuar dy procedura prokurimi “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”. Për zhvillimin e këtyre procedurave është marrë miratim paraprak nga Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU). Por, në zbatim të nenit 60 të VKM nr. 914, datë 20.12.2014, BUKF duhet të bënte përpjekje dhe të insistonte duke filluar që me hartimin e projekteve të zbatimit për ti kërkuar MBZHRAU financimin e këtyre objekteve, dhe që në momentin e miratimit të ligjit të buxhetit të shtetit në muajin dhjetor 2016 do të krijoheshin kushtet për fillimin e menjëhershëm të procedurave të “Hapur” dhe në këtë mënyrë do të shmangeshin procedurat “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës. Konkretisht, për shkak të vonesave nga MBZHRAU janë realizuar këto procedura me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës:

- Procedura e prokurimit me objekt: “Mbrojtja nga Lumi Vjosë në Pishporo Fier” me fond limit në vlerën 32,921,751 lekë;

-Procedura e prokurimit me objekt: “Urë barazhi Laguna Kravasta” me fond limit 2,224,804 lekë, të realizuar në vitin 2017.

(Më hollësisht, trajtuar në faqet 3-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi:

Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Fier dhe Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, çdo fund viti, që me miratimin e ligjit për buxhetin e shtetit, nëse janë planifikuar fonde, për çdo procedurë prokurimi duhet ti referohet nenit 60 të VKM nr. 914, datë 20.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim eliminimin e përdorimit të procedurës “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Për çdo rast përdorimi të kësaj procedure, duhet të dokumentohet dhe të argumentohet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 33, të Ligjit nr. 9 643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe neni 36, të VKM nr. 914, datë 20.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe të merret miratim nga Ministria e Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia e Prokurimit Publik.

Në vijimësi

1. 2. Gjetje: Në procedurën e prokurimit me objekt “ Blerje karburanti gazoil për vitin 2017” me fond limit 30,957,597 lekë, me procedurë të Hapur.

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik: “B...” dhe “E...” . Është kualifikuar dhe është shpallur fitues operatori “B...” me marzhin i fitimit (ofertën ekonomike) 17.4 % dhe janë s’kualifikuar 2 operatorët e tjerë një nga të cilët i cilit ka pasur marzhi i fitimit 6 % ose më të ulët se operatori i shpallur fitues me diferencë 11.4%.

Operatori ekonomik A., është skualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse, nuk ka paraqitur vërtetimi nga organet tatimor për shlyerjen e detyrimit të sigurimeve shoqërore. Po kështu edhe Operatori ekonomik “E...” është skualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse, i mungon marrëveshje e noterizuar për objektin e prokurimit dhe pjesën për secilin operator sipas VKM nr. 914 datë 30.12.2014. Por meqenëse ky operator ekonomik (“E...”) ka pasur marzhi i fitimit më të ulët se operatori fitues me diferencë rreth 11.4%, KVO munde ti kërkonte sqarime për këtë mangësi dhe nëse mbas sqarimeve bindej se operatori kishte marrëveshjen e noterizuar para hapjes së procedurës mundë ta konsideronte këtë mangësi devijim të vogël dhe ta kualifikonte operatorin “E...”, kështu do të kishim edhe kursim të fondeve si pasoj e mazhit të fitimit me i ulët me diferencë 11.4%.

(Më hollësisht, trajtuar në faqet 22-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.2. Rekomandimi:

Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Fier, në çdo procedurë prokurimi për mallra,shërbime dhe punë në rastet kur konstatohen mangësi në dokumentacionin teknik të operatoreve pjesëmarrës, ti kërkohet këtyre operatorëve sqarime për mangësitë e konstatuara, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e

tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”.

Në vijimësi

2. Gjetje. Për kryerjen e veprimtarisë në shërbim të mbrojtjes së territorit nga përmbytjet dhe erozioni, Bordi i Kullimit Fier ka në inventar 10 ekskavatorë të tepeve të ndryshme krahë gjatë 18 ml të cilët përballojnë volumin e punimeve në 3 rajonet e jugut. Për çdo mjet janë përcaktuar normativat harxhimit të Karburantit në bazë të volumit të punës së kryer në një orë punë për çdo tipit të ekskavatori. Nga auditimi për saktësinë e përdorimit të karburantit sipas volumit të punimeve dhe normative sipas objekteve u verifikuan disa objekte dhe nuk konstatua konsum i tepërt të harxhimit karburantit mbi normativat e përcaktuara. Por, për monitorimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha punimeve në këtë rajon Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratë me subjektin privat “I...” me vlerë 440,000 lekë dhe nga verifikimi i kryer në raportet ditore të mbajtura konstatohet se, nuk janë dokumentuar volumet ditore të punimeve për secilin mjet, veprim i cili, për nga mënyra e përlllogaritjes matematikore do të evidentonte volumet e punimeve nëpërmjet matjeve topografike për çdo ditë pune. Kjo mënyrë evidentimi dhe dokumentimi e punimeve nuk pasqyron nëse volumet e punimeve të kryera për objektin janë shumatore e gjithë ditëve të punimeve të kryera në objekt, për të evidentuar nëse punimet janë të barabarta me preventivin fillestar 2018.

(Më hollësisht, trajtuar në faqet 26-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Rekomandimi:

Volumet ditore të punimeve të dokumentohen për secilin mjet dhe për çdo ditë pune të kryera në objekt, me qëllim mbledhjen volumeve në mënyrë progresive për të evidentuar dhe saktësuar nëse sasitë e kryera janë të barabarta me sasitë e përcaktuara në preventivin fillestar.

Në vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

Grupi i Auditimit

Bashkim Arizaj
Andrea Kristo
Valentina Golemi
Aldo Kume